

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	287.165.666	288.347.515
Investime		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese aksione te veta</i>		
<i>Te tjera financiare</i>		
Te drejta te arketueshme		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	257.423.690	236.968.275
<i>Te drejta te arketueshme nga OSHEE</i>	12.931.872	
<i>Nga proceset gjyqesore</i>	13.266.336	
<i>Te tjera shteti</i>	3.826.203	18.452.590
<i>Kapital i nenshkuar i papaguar</i>		
Inventaret		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme/Inventari</i>	100.071.414	98.239.567
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>		
<i>Produkte te gatshme</i>		
<i>Mallra</i>		
<i>Aktive biologjike (gje e gjalle ne rritje dhe majmeri)</i>		
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>		
<i>Parapagime per inventar</i>		
Shpenzime te shtyra		
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		
Totali i aktiveve afatshkurtra	674.685.181	642.007.947
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate</i>		
<i>Te drejta per t'u arketuar afatgjate</i>	122.711.350	127.831.488
Aktive materiale		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	655.603.899	683.568.177
<i>Impiante dhe makineri</i>	6.338.954.173	6.422.170.790
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	345.129.722	384.561.807
<i>AAGJM te mbajtura per investim</i>		
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>	23.377.190	24.641.393
Aktivitet biologjike		
Aktive jo materiale		
<i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i>	31.499.423	37.920.155
<i>Emri i mire</i>		
<i>Parapagime per AAJM</i>		
Aktivitet tatimore te shtyra		
Totali i aktiveve afatgjate	7.517.275.757	7.680.693.810
TOTALI I AKTIVEVE	8.191.960.938	8.322.701.757

DETYRIMET DHE KAPITALI**Detyrime afatshkurtra**

<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	444.719	297.036
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	6.377.860	5.226.976
<i>Deftesa te pagueshme</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	2.267.079	2.893.550
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	1.988.835	
<i>Te tjera te pagueshme</i>	4.784.921	3.728.312
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra	211.103.403	150.111.487
Provizione		
Totali i detyrimeve afatshkurtra	226.966.817	162.257.361

Detyrime afatgjata

<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	5.051.198.009	5.066.306.070
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>		
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>		162.432.411
<i>Deftesa te pagueshme</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te tjera te pagueshme</i>		
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra	2.504.113.025	2.522.044.478
Provizione		
<i>Provizione per pensione</i>		
<i>Provizione te tjera</i>		
Detyrime tatimore te shtyra		
Totali i detyrimeve afatgjata	7.555.311.034	7.750.782.959

Detyrime totale

7.782.277.851	7.913.040.320
----------------------	----------------------

Kapitali dhe Rezervat

Kapitali i nenshkruar	370.708.000	370.708.000
Primi i lidhur me kapitalin		
Rezerva rivleresimi	6.407.302	6.407.302
Rezerva te tjera		
<i>Rezerva ligjore</i>	4.704.906	4.667.073
<i>Rezerva statutore</i>	27.122.404	27.122.404
<i>Rezerva te tjera</i>		
<i>Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		
Fitimi/(humbja) e pashperndare		
Fitimi/(humbja) e periudhes	740.475	756.658
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	409.683.087	409.661.437
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	409.683.087	409.661.437

TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT

8.191.960.938	8.322.701.757
----------------------	----------------------

Pasqyra e Performances (sipas natyres)

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	350.014.311	359.136.301
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces		
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	4.539.648	8.637.638
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	50.029.411	67.610.450
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	(35.234.366)	(54.256.693)
<i>Te tjera shpenzime</i>		
Shpenzime te personelit		
<i>Paga dhe shperblime</i>	(83.408.961)	(81.440.053)
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	(14.915.141)	(14.469.405)
<i>Shpenzimet per pensionet</i>	(6.644.100)	(6.515.347)
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(178.766.727)	(200.444.359)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	(31.165.794)	(40.985.452)
Te ardhura te tjera		
<i>Te ardhura te tjera shitje e aktiveve</i>	271.717	
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese pjese e aktiveve afatgjata *</i>		
<i>pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata</i>		
<i>Te ardhura nga interesat dhe kamatvonesat</i>	12.617.483	14.632.432
<i>Te ardhura nga arketimi i provizionit</i>	1.480.224	1.342.299
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		
Shpenzime financiare		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	(79.157.659)	(61.249.245)
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite</i>		
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>		
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet	11.402.351	9.413.234
Te tjera (pershkruaj)		
Fitimi/(humbja) para tatimit	1.062.397	1.411.800
Tatimi mbi fitimin		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	(321.922)	(655.142)
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>		
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>		
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	740.475	756.658
Te ardhura te tjera gjithepershires per periudhen/vitin:		
<i>Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		
<i>Te tjera (pershkruaj)</i>		
Totali i te ardhurave te tjera gjithepershires per periudhen/vitin (B)	-	-
Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen/vitin (A+B)	740.475	756.658
Totali i te ardhurave gjithepershires per :		
Pronaret e njesise ekonomike meme		
Interesat jo-kontrollues		

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda direkte)		
	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Te arketuara nga te drejtat e arketueshme	400.439.114	413.942.350
Te paguara per detyrime e pagueshme dhe detyrimet per punonjesit	(175.942.158)	(228.709.364)
Pagesa te tjera	(85.447.826)	(90.491.302)
Te tjera (<i>pershkruaj</i>)		
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti i shfrytezimit		
Interes i paguar		
Tatim fitimi i paguar	(964.086)	(5.601.261)
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	138.085.044	89.140.423
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(155.903.308)	(128.815.974)
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Para te perdorura per blerjen e filjaleve (netuar me shumen e mjeteve monetare pjese e aktiveve neto te blera)		
Para te arketuara nga shitja e filjaleve (netuar me shumen e mjeteve monetare pjese e aktiveve neto te shitura)		
Pagesa per blerjen e investimeve te tjera		
Arketime nga shitja e investimeve te tjera		
Dividende te arketuar		
Te tjera (<i>pershkruaj</i>)	33.783.962	38.582.433
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(122.119.346)	(90.233.541)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar		
Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura si kolateral		
Hua te arketuara		
Pagesa e kostove te transaksionit qe lidhet me kredite dhe huate	(526.173)	(222.511)
Riblerje e aksioneve te veta		
Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		
Pagesa e huave	(13.722.051)	(14.400.249)
Pagese e detyrimeve te qirase financiare	(2.238.004)	(3.983.867)
Dividende te paguar	(661.319)	(16.864.763)
Te tjera (<i>pershkruaj</i>)		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	(17.147.547)	(35.471.390)
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	(1.181.849)	(36.564.508)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	288.347.515	324.912.023
Efekti i luhatjeve te kurset te kembimit te mjetet monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	287.165.666	288.347.515

Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A

Shënimit Shpjeguese Pasqyrat Financiare 1 Janar -31 Dhjetor 2020

Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto										
	Kapitali i nenshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva rivleresimi	Rezerva te tjera	Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja	Fitimet/ (humbjet) e pashperndara	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali	Interesa jo-kontrollues	Totali
Pozicioni financiar ne fillim	370.708.000	0	6.407.302	31.789.477	0	0	756.658	409.661.437	-	409.661.437
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile								-		-
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	370.708.000	0	6.407.302	31.789.477	0	0	756.658	409.661.437	-	409.661.437
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:								-		-
Fitim/(humbja) e periudhes								-		-
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse								-		-
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital								-		-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	0	0	0	0	-	-	-	-
Transaksione per pronaret e njësish ekonomike te njohura direkt ne kapital:								-		-
Emetim i kapitalit të nënshkruar								-		-
Dividende te shperndare				37.833,00			(756.658)	(718.825)		(718.825)
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)								-		-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësish ekonomike	0	0	0	37.833	0	0	(756.658)	(718.825)	-	(718.825)
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)	370.708.000	0	6.407.302	31.827.310	0	0	-	408.942.612	-	408.942.612
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:								-		-
Fitim/(humbja) e periudhes							740.475	740.475		740.475
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse								-		-
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital								-		-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	0	0	0	0	740.475	740.475	-	740.475
Transaksione per pronaret e njësish ekonomike te njohura direkt ne kapital:								-		-
Emetim i kapitalit të nënshkruar								-		-
Dividende te shperndare								-		-
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)								-		-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësish ekonomike	0	0	0	0	0	0	-	-	-	-
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	370.708.000	0	6.407.302	31.827.310	0	0	740.475	409.683.087	-	409.683.087

SHËNIME SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i përgjithshëm

Njësia ekonomike “Ujësjetllës Kanalizime Korçë” Sh.A. është krijuar si Shoqëri Aksionare në datën 17.03.2000, me aktivitet kryesor:

- a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901 date 14.04.2008, “Per tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statutit të Shoqërisë, VKM Nr. 63 datë 27.1.2016 “Për Riorganizimin e Operatorëve që Ofrojnë Shërbimin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimin, Largimin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura”

Njësia ekonomike “Ujësjetllës Kanalizime Korçë” Sh.A. është subjekt tatimor dhe kryen veprimtari ekonomike me NUIS: J641031410, vendi i kryerjes së veprimtarisë Bashkia Korçë.

Organet e drejtimit të shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit

Bashkia Korçë zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë me vlerë 370.708.000 lekë

Këshilli i Administrimit është i përbërë nga 3 anëtarë;

- a) Petraq Premti (kryetar)
- b) Arto Adili (anëtar)
- c) Petrit Tare (anëtar)

Administrator i Shoqërisë është Z. Petrit Tare

Numri mesatar i punonjesve për vitin 2020 është 121 punonjës.

Numri mesatar i punonjesve për vitin 2019 është 115 punonjës

Përsonei përgjegjës për përpunimin e informacionit për hartimin e pasqyrave financiare: Znj. Elia Pendavinji - Drejtore Tregëtare.

Auditues Ligjore:

- **“FILTO- AUDITING” Shpk** me Znj. Tatiana Filto - Audituese Ligjore/Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar) me nr. Liçense 67 datë 31.01.2000;
- **Ilda Ekonomi** Audituese Ligjore/Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar) me nr. Liçense 103 datë 15.10.2008;

Pagesat per Auditimin ne vitin 2020 jane 814.000 leke

Referuar përkufizimit të nenit 3.7 te ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A, përkufizohet si Njësi ekonomike fitimprurëse.

“Ujësjetllës Kanalizime Korçë” Sh.A klasifikohet si Njësi ekonomike e mesme bazuar në Nenin 4.1.3. të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" pasi ne daten e raportimit 31 dhjetor 2020, nuk tejkalon kufijtë e të pakten dy prej 3 kriterëve të nenit 4.1.3 për :

- a) Aktivin
- b) Te ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi).
- c) Numrin mesatar te punonjesve per periudhen raportuese 1 Janar-31 Dhjetor 2020.

Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kombëtare te Kontabilitetit SKK te permiresuara Nr.2.

- a) Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare janë ato të përshkruara në SKK 1, paragrafi 40 – 90.
- b) Parimi i njësisë ekonomike:mban në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta;
- c) Parimi i vijimësisë: veprimtaria ekonomike e njësisë raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj;
- d) Kompensimi: Në përputhje me parimin e kompensimit të përshkruar në paragrafët 64 dhe 65 të SKK 1,
- e) Parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm nëse njësia ekonomike ka të drejtë ligjore t’i kompensojë aktivet dhe detyrimet si dhe ekziston mundësia që ajo ta përdorë këtë të drejtë; Të ardhurat dhe shpenzimet nuk do të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të atyre të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga aktivitetet dytësore, apo që kanë ardhur nga një ose disa veprime të ngjashme, apo,që të marra veças nuk janë materiale;
- f) Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qënë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit;
- g) Materialiteti është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zëra materiale.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKK Nr.1 janë:

- a) Parimi i paraqitjes me besnikeri;
- b) Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
- c) Parimi i pa-anëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;
- d) Parimi i maturisë pa optimizem të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm;
- e) Parimi i plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare;
- f) Parimi i qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël;
- g) Parimi i krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave;

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj nga data 01.01.2020 - 31.12.2020.

2. Deklarata e pajtueshmërisë

Deklarimet financiare të bashkangjitura janë përgatitur në bazë të rregjistrimeve kontabël të mbajtura për qëllime të kontabilitetit të vendit konform Ligjit 25/2018 datë 10 Maj 2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat Financiare të fund vitit janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Përgatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SKK, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rëndësishme. Kjo gjithashtu kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjten periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabël dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të një programi të kontabilitetit alpha si dhe Programin e shitjes Faturim e arketim.

2.1 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Shumat janë paraqitur në Leke përveç rasteve ku citohet ndryshe.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.4 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

2.7 Instrumentat financiare

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, përfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus, çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me, nese detyrimet e Kompanise te specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

2.7.1 Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

2.7.2 Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

2.7.3 Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

2.7.4 Huate bankare dhe te tjera

Në vazhdim të njohjes fillestare, huatë bankare dhe të tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo diference midis koston dhe vlerës së rikuperueshme në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të një interesi efektiv.

2.7.5 Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto të amortizueshme duke përdorur metodën e interest efektiv, minus ëdo humbje nga zhvlerësimi.

Aktivitetet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra përveç rasteve kur kompania ka të drejtë të pakushtezuar të ndryshojë marrëveshjen e huasë për të pakten 12 muaj pas datës së bilancit.

2.8 Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlerëson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e Zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ka faktore objektive që tregojnë që inventaret janë zhvlerësuar.

2.9 Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivët Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit është mbi bazën e metodës zbritese.

Toka dhe Nderimet në Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabel. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.10 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Njohja dhe Matja Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja mëpashme: AAM-të paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kosto fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabel aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësia ekonomike ka përdorur metodën e amortizimit mbi bazën e vlefës së mbetur të AAM-ve. Normat e amortizimit të përdorur janë në përputhje me normat e përcaktuara në ligjin 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Para aplikimit normat janë miratuar nga Aksionari i Njesisë sipas Vendimit Nr 2 datë 13.02.2020, sipas tabelës së mëposhtme:

Shoqëria nuk zoteron Aktive Afatgjata Jo Materiale

2.11 Kuotat e kapitalit

Aksionet njihen si kapital. Vlera nominale e një aksioni është 1000 lekë dhe në total Numri i aksioneve është 370.708 aksione .

2.12 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile të aktiveve jofinanciare të Kompanisë, përveç inventareve dhe tatimeve të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi

njihet nese vlera kontabile e nje aktivi eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normen e skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivitetit.

Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe do te ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

2.13 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te fluksesve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjetere e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anulohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anullimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

2.14 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte te përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te Kompanise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

2.15 Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

2.16 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.17 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore permban shpenzimin tatimor aktual (te ardhuren tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor te shtyre (te ardhuren tatimore te shtyre). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.18 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

2.19 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Euro	123.70	121.77

3. Mjete monetare në arkë e në bankë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Banka	287.165.666	288.347.515
Arka		
Totali	287.165.666	288.347.515

Gjëndjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me tepricat e llogarive bankare dhe inventaret fizike të mjeteve monetare në arken e kompanisë. Njohja, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshem I ketij instrumenti financiar eshte bere ne perputhje me paragrafet nr 11-21 te SKK-se se permiresuar nr.3 “Instrumentat Financiare”.

Shoqeria ka llogari bankare të gjitha bankat e nivelit të dytë që operojnë në Korçë; Banka Kombetare Tregtare, Raiffaisen Bank, Pro Credit Bank, Otpbank, Tirana Bank, Alpha Bank, Union Bank dhe Credins Bank.

4. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti

Balanca e llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti shfytëzimit të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme	300.648.878,00	280.707.928,00
Zhvleresimi kerkesave te arketueshme	(31.464.042,00)	(31.978.507,00)
Te drejta te arkëtueshme/ proceset gjyqesore	(11.761.146,00)	(11.761.146,00)
Totali	257.423.690,00	236.968.275,00

Të drejta të arkëtueshme të ndara sipas kategorive paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Familiarë	237.197.391	215.719.114
Biznese	7.305.314	6.756.275
Institucione	12.920.985	14.492.886
Total	257.423.690	236.968.275

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e drejtimit.

Njësia ekonomike ka llogari të arkëtueshme ne datën 31.12.2020 me vlerë 257.423.690 lekë ku përfshihen faturat e konsumit të ujit për klientet në zonën e juridiksionit, debitorët faturat e të cilëve nuk janë arkëtuar. Kjo klasë rishikohet çdo vit dhe krijohet provizion sipas SKK 6 .

Në mbeshtetje të Ligjit Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi Të ArdhuratI Ndryshuar”, si edhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 6 Provizionet, Detyrimet Dhe Aktivitet E Kushtëzuara, Shoqëria krijoi dhe miratimoi provizion nga Këshilli i Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithëshme vlerën prej 964.983 lekë për vitin 2020 për klasën “Të drejta të arkëtueshme”- Nga aktiviteti i shfrytëzimit i emërtuar në llogaritë e kontabilitetit si Llogaria 411.

Gjatë viti të drejtat e arkëtueshme të cilat kalohen në provizion mund të rimerren në formën e arketimit të faturave të prapambetura të cilat kontabiliohen në të ardhura të patatuehshme për efekt fiskal. *Provizionet e krijuara gjatë vitit ushtrimor dhe të regjistruara në kontabilitet, të cilat janë pasqyruar si shpenzime të panjohura për efekt fiskal, kur rimerren, do të konsiderohen si të ardhura të patatueshme ose shpenzime të njohura për efekt fiskal. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, dt. 23.05.2014. Botuar në Fl .Z Nr. 80, dt. 4 qershor 2014)*

	2020	2019
Rimarrje për vitin	1.480.224	1.342.299
Gjendja më 31 dhjetor	1.480.224	1.342.299

Llogari te arkëtueshme nga OSHEE me vlerë 12.931.872 lekë, përbëhet nga fatura sistemuese e balancimit të energjisë.

5. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shteti debitor për tatim fitimin për vitin 2019 me vlerë	3.826.202	3.184.038
Shteti- TVSH për tu marrë		3.507.406
Totali	3.826.202	6.691.444

6. Te drejta të arketueshme nga proceset gjyqesore

Përfshihen kliente të cilët janë debitorë ndaj Shoqërisë, të cilët janë në proces përbarimor për arkëtim me vlerë totale 11,761,146 lekë si edhe tarifa e përbaruesit prej 1.505.188 lekë.

7. Inventarë

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lënda djegëse, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	100.071.414	98.239.567
Totali	100.071.414	98.239.567

Shoqëria ka kryer inventarizimin me gjatë vitit 2020 dhe nuk ka konstatuar diferenca.

Gjatë inventarizimit janë vërejtur mallra me qarkullim të ulët apo në disa raste pa qarkullim fare, kryesisht materiale të cilat kanë ardhur pas mbarimit të Projekteve të implementuara gjatë viteve të fundit në UKKO.

Për këto materiale janë ngritur komisione për rivlerësimin e tyre, procedurë e cila nuk mund të përfundohej plotësisht si rezultat i vonësive nga Covid dhe mungesës së ofertimeve për ekspert vlerësuar gjatë procedurës së tenderimit. Shoqëria do të vazhdojë gjatë vitit 2021 procedurën e rivlerësimit të inventarit.

AKTIVE TOTALE AFATSHKURTRA

Viti 2020	661.753.309 lekë
Viti 2019	642.007.947 lekë

8. Tituj të tjerë të huadhënies (të drejta të arkëtueshme)

Zëri kryësor i kësaj klase përbëhet 122,711,350 lekë në bazë të Marrëveshjes ndërmjet Ujësjetllës Kanalizime Korçë dhe Bashkisë Korçë është nënshkruar një Marrëveshje “Mbështetjen financiare për Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Korçë nga Bashkia Korçë” në datën 04.02.2010 me Nr Prot 45 ku Palët Bashkia Korçë merr angazhim të mbështesë UKKO për një periudhë 16 vjeçare në total 1.390.000 Euro.

9. Aktivet afatgjata materiale dhe Jomateriale

Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM) dhe Jomateriale (AAJM)

Njohja dhe Matja Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja mëpashme: AAM-të paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësia ekonomike ka përdorur metodën e amortizimit mbi bazën e vlefës së mbetur të AAM-ve. Normat e amortizimit të përdorur janë në përputhje me normat e percaktuara në ligjin 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Para aplikimit normat janë miratuar nga Aksionari i Njesisë sipas Vendimit Nr 2 datë 02.03.2021, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	EMERTIMI I AKTIVEVE AFATGJATA	Norma e amortizimit	
		2020	e amortizimit 2020
		UJESJELLES	KANALIZIME
1	Ndërtesat	5%	
2	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme/ Impianti Fotovoltaik	5%	
3	Instalime specifike dhe komplekse	1.0%	1.0%
4	Matesat elektronik/mekanik	8%	
5	Makineri dhe pajisje pune	20%	
6	Mjete transporti	20%	
7	Mobilje orëndi	20%	
8	Mjete kompjuterike	25%	
9	Aktive Afatgjata jo materiale	15%	

Aktivët afatgjatë materiale përbëhen si më poshtë:

	Toka	Ndërtesa	Rrjeti shperndares & Kanalizime	Pajisje Zyre & informatike	Totali i aktiveve Afatgjata jo Materiale	Aktive Afatgjata Jomateriale
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 1 janar 2019	13.214.592	952.259.555	7.567.698.829	716.084.142	9.249.257.118	316.856.921
Shtesa		1.425.415	370.963.036	8.189.529	380.577.980	724.358
Pakësime					-	(272.936.361)
Riklasifikime midis grupeve					-	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	13.214.592	953.684.970	7.938.661.865	724.273.671	9.629.835.098	44.644.918
Shtesa		5.622.287	20.470.482	3.299.312	29.392.081	284.925
Pakësime			(7.943.990)	(4.427.236)	(12.371.226)	
Riklasifikime midis grupeve					-	
Gjendja më 31 dhjetor 2020	13.214.592	959.307.257	7.951.188.357	723.145.747	9.646.855.953	44.929.843
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 1 janar 2019		248.124.638	1.419.001.733	290.849.127	1.957.975.498	260.775.590
Amortizimi i penudhës		35.206.746	97.489.343	48.862.737	181.558.826	6.630.014
Shtesa					-	(260.680.841)
Riklasifikime midis grupeve					-	
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	283.331.384	1.516.491.075	339.711.865	2.139.534.324	6.724.763
Amortizimi i penudhës		33.586.565	95.782.828	42.731.397	172.100.790	6.705.657
Pakësime			(39.720)	(4.427.236)	(4.466.956)	
Riklasifikime midis grupeve					-	
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	316.917.949	1.612.234.184	378.016.025	2.307.168.158	13.430.420
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	13.214.592	670.353.586	6.422.170.789	384.561.806	7.490.300.774	37.920.155
Gjendja më 31 dhjetor 2020	13.214.592	642.389.308	6.338.954.173	345.129.722	7.339.687.795	31.499.423

10. Aktivet në proces

Përbëhet nga investime të realizuara së fundmi nga UKKO në përmirësimin e rrjetit ujësjellës rritjes së kapacitete të burimeve dhe sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm për banorët e fshatrave si edhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve me vlerë 31.499.423 lekë.

DETYRIMET DHE KAPITALI**11. Arkëtime në avancë për porosi**

Viti 2020 444.719 lekë

Viti 2019 297.035 lekë

Përbëjnë fagtura të paguara dy herë nga klientët dhe që UKKO do ti sistemojë në vijëmesi.

12. Të ardhura për aktivetin e shrytëzimit

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitore për mallra	809.644	
Furnitore për shbime	1.431.944	1.509.432
Energji elektrike	4.117.485	3.442.941
Uje	18.787	274.603
Totali	6.377.860	5.226.977

13. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Sigurime Shoqerore shendetesore	2.153.503	2.046.144
Sigurimet shoqerore te projektit SSW	7.437	39.911
Shpenzime paga per keshillim e Administrimit	37.570	
paga per tu paguar SSW	59.569	242.597
Te tjera	9.000	9.000
Totali	2.267.079	2.337.652

14. Te pagueshme per detyrime tatimore

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Tatim ne burim	6.630	6.630
TVSH per t'u paguar	1.460.400	
TAP	521.805	503.404
TAP SSW		45.866
Totali	1.988.835	555.900

15. Të tjera të pagueshme

Viti 2020	4.784.921 lekë
Viti 2019	3,728,314.00 lekë

Përfshihen taksat e Bashkisë që qytetarët paguajnë në fatyrën e ujit. Këto vlera arkëtohen nga UKKO nëpërmjet arketimit të faturave dhe më pas depozitohen në degën e Të Ardhuave të Bashkisë.

16. Të ardhura të shtyra

Viti 2020	211.103.403 lekë
Viti 2019	150.111.487 lekë

Përbëhen nga Shpenzime të interesave të papaguara të kredive dhe Sistemimi I granteve/ sistemim dalja e materialeve nga magazina.

17. Detyrime ndaj institucioneve te kredise

Detyrime ndaj institucioneve të kredisë 2020	5.051.198.009 lekë
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë 2019	5.066.306.070 lekë

Përfshihen të gjitha detyrimet ndaj institucioneve Financiare për kreditë e marra nga UKKO. Që prej vitit 2007 UKKO ka nisur të shlyejë kreditë sipas Amortizimeve përkatëse.

18. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra afatgjata 2020	2.504.113025 lekë
Të ardhura të shtyra afatgjata 2019	2.522.044.478 lekë

Përshihen Grante afatgjata që ukko ka përfituar gjatë investimeve të kryera në rrjetin Ujësjellës dhe Kanalizime. Vlera është në vlerë neto duhe zbritur amortizimet vjetore të asete.

19. Kapitali

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kapitali	370.708.000	370.708.000
Rezerva Rivleresimi	6.407.302	6.407.302
Rezerva ligjore	4.704.906	4.667.073
Rezerva statutore	27.122.404	27.122.404
Fitim/Humbje e Vitit	740.475	756.658
Totali	409.683.087	409.661.437

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET**20. Të ardhurat**

Detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Te ardhura nga shitja e Produktit te vet	344.137.082	351.420.174
Te ardhura nga shitja e Shërbimeve	3.385.606	5.422.127
Te ardhura nga shitja e Mallrave	2.491.623	2.294.000
Qeraja		1.364.780
Prodhim i aktiveve afatgjata	4.499.459	8.637.638
Të ardhura nga grantet (Subvencione)	50.029.411	65.248.282
Të tjera	40.189	997.388
Te ardhura nga Interesat banakare dhe diferenca konvertimi	12.617.483	14.632.432
Te ardhura te tjera		1.342.299
Të ardhura nga arketimi I provizionit	1.480.224	
Të ardhura nga diferenca konvertimi	12.638.095	10.010.203
Te ardhura nga shitja e aktiveve	271.717	
Totali	431.590.889	461.369.322

21. Shpenzimet

Detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shpenzime materiale dhe materiale të tjera	13.947.970	21.277.987
Shpenzime per sherbime (energji, Uje)	21.286.396	32.978.706
Pagat e personelit	83.408.961	81.440.053
Shpenzimet për sig.shoqërore dhe shëndetsore	14.915.141	14.469.405
Trajtime dhe shpërblime të tjera	6.644.100	6.515.347
Amortizimet dhe zhvlerësimet	178.766.727	188.188.840
Mirembajtje dhe riparime	2.528.350	2.735.500
Shpenzime për Siguracione	1.754.578	1.686.520
Sherbime të tjera (Roje+largim mbetjesh)	16.341.606	15.710.962
shpenzime printim fature	1.205.615	1.494.755
Personel jashte njesise	1.434.685	1.344.400
Shpenzime per koncesione, patenta dhe licensa	3.232.234	3.151.832
Shpenzime per publicitet, reklama	392.160	210.800
Transferime, udhetime, dieta	390.351	1.760.104
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1.211.967	1.099.550
Shpenzime per sherbime bankare	182.346	186.893
Taksa dhe tarifa vendore	469.795	84.050
Taksa e regjistrimit dhe tatime te tjera		453.239
Shpenzime për interesa dhe diferenca konvertimi	80.393.402	61.846.214
Shpenzime të tjera	1.057.125	6.928.347
Provizion	964.983	4.138.500
Shpenzime zhvleresimi		12.255.519
Totali	430.528.491	459.957.522

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi i periudhës		
Fitimi	1.062.397	1.411.800
Tatim fitimi	321.922	803.158
Fitimi neto	740.475	608.642

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (Metoda direkte)

Pasqyrat fluksi monetar është hartuar sipas SKK 2 .Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike gjatë periudhës kontabël. 62. Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare jep informacion në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veças ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit.

Krahasuar me vitin paraardhës kemi një qëndrueshmëri të mjete monetare.

Pasqyra e fluksit monetar është hartuar sipas Metodës direkte.

PASQYRA E NDYSHIMEVE TË KAPITALIT - PERIUDHA 1 JANAR - 31 DHJETOR 2020

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto është hartuar sipas SKK 2 dhe paraqet fitimin e një njësie ekonomike ose humbjen për një periudhë të raportimit, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e performancës për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve të njohura në periudhën dhe shumat e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj investitorëve të kapitalit neto gjatë periudhës.

Kapitali I njesise ekonomike me vlere totale 370.708.000 leke eshte ne zoterim 100% të Bashkisë Korçë.

Nr i pjesëve të kapitalit është 370.708 me vlerë nominale të një pjese 1 000 lekë.

Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria/subjekti nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur

1. Çështja civile me nr. 447, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Objekti : Ankimi i Vendimit Nr. 791, datë 02.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për çështjen me objekt: "Pavlefshmëri absolute e kontratës me nr. klienti 660278 në emër të paditësit Kujtim Merolli. Rregullimin e pasojave të kësaj pavlefshmërie. Përfashtimin e paditësit nga detyrimi që prodhon kontrata me nr. klienti 660278."

Palët: Ankues: Paditësi Kujtim Merolli, i Paditur : UKKO Sh.A.

2. Çështja civile me nr. 356, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Objekti : Ankimi i Vendimit Nr. 429, datë 12.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë , për çështjen me objekt: " Anullimi i Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Këshillit të Rrethit Korçë Nr. 30 datë 24.04.1998 për sipërfaqen e tubacionit të kanalizimeve që përdorej për interes publik."

Palët: Ankues: Të paditurit Sali Shushka etj

Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A

Shënimet Shpjeguese Pasqyrat Financiare 1 Janar -31 Dhjetor 2020

3. Çështja civile me nr. 502, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Objekti: Ankimi i Vendimit Nr. 1276, datë 05.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për çështjen me objekt: "Detyrimin e palës së paditur për dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës

Palët: Ankues: Padiësi Ilo Vangjel, i Paditur : UKKO Sh.A.

Ilo Vangjel e ka ankimuar Vendimin , në Gjykatën e Apelit Korçë dhe çështja është regjistruar me nr. 502 dhe është në pritje për gjykim në Apel.) kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare

Ngjarje pas datës se bilancit

Me 31 Dhjetor 2020 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Elia Pendavinji

(Drejtoreshë Drejtoria Tregëtare)

Për Drejtimin e Njësisë Ekonomike

Petrit Tare

